



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor/Ministarstvo Sredine i Prostornog
Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

RAPORT PËRMBLEDHËS NGA PROJEKTI RINDËRTIMI I
INFORMACIONEVE KADASTRALE NË 50 ZONA KADASTRALE

2014/2015

Përmbajtje:

1. Hyrje
 - 1.1. Qëllimi i projektit
2. Informimi Publik
 - 2.1. Shpërndarja e postareve dhe flajerave dhe Takimet me banorët e Zonës Kadastrale
3. Fushata e matjeve
4. Shikimi Publik
5. Dorëzimi i të dhënave për kontrollë, shqyrtimi dhe aprovimi nga Komisioni për RIK
6. Futja e të dhënave në Modulin CRTool dhe CM
7. Aprovimi i Projektit
8. Dorëzimi i të dhënave finale nga projekti i RIK-ë 50 ZK
9. Konkluzionet

1. HYRJE

1.1. QËLLIMI I PROJEKTIT

Rindërtimi i kadastrit dhe i Regjistrimit të të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme (RIK) nënkupton krijimin e njërive kadastrale dhe rindërtimin e të drejtave pronësore për njësit kadastrale dhe regjistrimin e tyre në Kadastër dhe RDPP-SIKTK.

Projekti RIK realizohet sipas Ligjit Nr. 04/-L-013 për kadaster, neni 29, UA Nr. 02/2012 për Rindërtimin e Kadastrit dhe Regjistrimit të të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme, UA Nr. 03/2012 për punën e Komisionit për Rindërtimin e Kadastrit dhe Regjistrimit të të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme, UA Nr. 04/2012 Fushatën e Sensibilizimit për Publikun gjatë Rindërtimit të Kadastrit dhe Regjistrimit të të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme si dhe ligjeve dhe akteve tjera në fuqi.

Agjencia Kadastrale e Kosovës në bashkëpunim me Zyrat Kadastrale Komunale ka bërë përzgjedhjen e zonave kadastrale të cilat do të rindërtohen.

Nënshkrimi i kontratës ndërmjet Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe operatorëve ekonomik (Operatorëve Ekonomik: Lorenzo & Co and Geomatics - LOT 1 dhe Emi Grup Bilgi Teknologjileri Anonim Sirketi - LOT 2.

Pas nënshkrimit të kontratës operatorët ekonomik kanë sjell planin dinamik të realizimit të projektit i cili është aprovuar nga komisioni i AKK-së i cili njëkohësisht i ka dorëzuar operatorit ekonomik të gjitha të dhënat grafike dhe tekstuale që disponon AKK sipas Termave të Referencës (TeR).

Projekti RIK, gjatë realizimit të tij ka kaluar nëpër këto faza:

- a) Informimi Publik,
- b) Fushata e matjeve,
- c) Shkimi Publik,
- d) Dorëzimi i të dhënave për kontrollë, shqyrtimi dhe aprovimi nga Komisioni për RIK,
- e) Futja e të dhënave në Modulin CRTool dhe CM,
- f) Aprovimi i Projektit dhe
- g) Dorëzimi i të dhënave finale nga projekti RIK-ë 50 ZK.

2. INFORMIMI PUBLIK

Për planin e Rindërtimit të Kadastrit dhe të RDPP-së janë informuar të gjithë qytetarët e Kosovës sipas *UA Nr. 04/2012 Fushatën e Sensibilizimit për Publikun gjatë Rindërtimit të Kadastrit dhe Regjistrimit të të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme*, e në veçanti ata të komunës dhe të ZK ku zbatohet rindërtimi. Informimi është bërë edhe për institucionet e interesuara dhe bizneset që kanë interes nga procesi i rindërtimit. Të gjitha palët e interesuara dhe që kanë interes ligjor janë informuar lidhur me përfitimet nga rindërtimi, procedurat e posaçme të cilat aplikohen gjatë rindërtimit, të drejtat dhe obligimet e palëve si dhe për të kërkuar bashkëpunim në ekzekutimin e procesit të rindërtimit.

2.1 SHPËRNDARJA E POSTAREVE, FLLAJERAVE DHE TAKIMET ME BANORËT E ZONËS KADASTRALE

Para fillimit të zbatimit të planit të rindërtimit janë mbajtur takime me banorët e secilës ZK. Ftesa për takim është bërë së paku 7 ditë para se të mbahen takimet. Në ftesën për takim është shënuar data, vendi dhe ora e saktë e mbajtjes së takimit. Në ftesë është shënuar edhe qëllimi (rendi i ditës) i mbajtjes së takimit me banorët. Ftesa është bërë përmes pllakateve, fletëpalosjeve. Pllakatet janë vendosur në vendet publike ndërsa fletëpalosjet iu kanë dorëzuar banorëve në dorë. Takimet me banorët janë mbajtur kresisht jashtë orarit dhe ditëve të vikendit me qëllim që të kemi një informim sa më të mirë të banorëve të zonave dhe pjesëmarrja të jetë më e madhe. Takimet janë mbajtur në shkolla të fshatarave që kanë qenë pjesë e projektit RIK.

Në takimin me banorët e ZK-së kanë marrë pjesë përfaqësuesit e Komisionit të rindërtimit, ZKK-së dhe operatorit ekonomik. Takimi janë udhëhequr nga komisioni.

Gjatë takimeve të mbajtura për informim, banorët janë njoftuar:

1. për planin e rindërtimit, dinamikën e realizimit dhe rëndësinë e tij;
2. obligimet e AKK, ZKK, Komunës, komisionit në procesin e rindërtimit;
3. obligimet e operatorit ekonomik në zbatimin e planit të rindërtimit;
4. të drejtat dhe obligimet e banorëve të ZK në procesin e rindërtimit. Obligimi i banorëve për dorëzimin e dokumentacionit që posedojnë për pronat e veta. Informimi për përgjegjësitë e operatorit ekonomik dhe Komisionit të rindërtimit

për problemet dhe vështirësitë që i kanë lidhur me pronat e veta. Informim për proceset gjyqësore që janë në zhvillim;

- Rëndësinë e bashkëpunimit të gjitha palëve pjesëmarrëse në procesin e rindërtimit.

Kjo fazë e realizimit të projektit RIK-ë është realizuar në të gjitha Zonat Kadastrale që kanë qenë pjesë e projektit RIK, sipas këtij plani:

LOT 1

Fushata e Informimit					Informim Shtesë
Komuna	Nr.	Zona Kadastrale	Data	Ora	Data
DRENAS	1	Abri e Epërme	28.10.2014	19:00	10.09.2015
	2	Gllanasellë		16:00	
	3	Negroc	29.10.2014	17:30	22.10.2015
	4	Likoshan	28.10.2014	17:30	
	5	Fushtice e Epërme	29.10.2014	16:00	
SKENDERAJ	1	Prekaz i Epërm	26.10.2014	14:30	17.09.2015
	2	Prekaz i Poshtëm		13:00	17.09.2015
	3	Skenderaj		11:00	16.09.2015
	4	Klinë e Ndërmjetme	27.10.2014	16:10	16.09.2015
	5	Kryshevc		16:00	15.09.2015
	6	Aqareve		19:00	11.09.2015
	7	Marinë		17:30	11.09.2015
VUSHTRRI	1	Nevolan	30.10.2014	16:00	
	2	Bivolak	31.10.2014	16:00	21.09.2015
	3	Lum Madh		18:00	21.09.2015
	4	Ceceli	30.10.2014	18:00	21.09.2015
SUHAREK	1	Suharekë	01.11.2014	11:00	30.09.2015
	2	Reshtan		12:30	21.09.2015
	3	Peqan		14:00	21.09.2015
	4	Studenqan		15:30	22.09.2015
	5	Grejkovc		17:00	22.09.2015
ISTOG	1	Istog	25.10.2014	11:00	01.09.2015
	2	Lubovë		14:00	01.10.2015
	3	Saradran		15:30	01.10.2015
	4	Kovragë		12:30	01.09.2015

LOT 2

Fushata e Informimit					Informim Shtesë
Komuna	Nr.	Zona Kadastrale	Data	Ora	Data
SHTIME	1	Shtime	26.10.2014	11:00	
	2	Vojnoc	25.10.2014	11:00	
	3	Muzeqinë	25.10.2014	12:30	
	4	Petroviq	26.10.2014	12:30	
	5	Rashincë	25.10.2014	14:00	
	6	Davidovc	25.10.2014	15:30	
	7	Gjurkoc	26.10.2014	14:00	
HANI I ELEZIT	1	Seqishte (Burim)	01.11.2014	11:00	
	2	Gorancë	01.11.2014	12:30	
	3	Paldenicë	01.11.2014	14:00	
KAÇANIK	1	Kaçanik	23.10.2014	19:00	
	2	Bob	23.10.2014	17:30	04.11.2015
	3	Runjevë	23.10.2014	16:00	29.10.2015
	4	Kaçanik i Vjetër	24.10.2014	17:00	
	5	Begracë	24.10.2014	18:30	
OBILIQ	1	Plemetin	30.10.2014	17:00	
	2	Leshkoshiq	30.10.2014	18:00	
	3	Sibovc	31.10.2014	17:00	
	4	Grabovc i Epërm	31.10.2014	18.30	
MALISHEVË	1	Bellanic	27.10.2014	17:00	
	2	Malishevë	28.10.2014	18:30	
	3	Banjë	27.10.2014	18:30	
	4	Llashkadrenoc (Drenoc)	29.10.2014	17:00	
	5	Damanek	28.10.2014	17:00	
	6	Kijevë	29.10.2014	18:30	

Në takimet e mbajtura me rastin e informimit publik në bazë të ligjit Ligji Nr. 04/-L-013 për Kadastër dhe Udhëzimeve Administrative në fuqi është bërë zgjedhja e përfaqësuesve të secilës ZK ku zhvillohet Projekti, i cili do të jetë pjesë e Komisionit të RIK-ut.

Anëtarët e Komisionit nga ZK ku është realizuar Projekti i RIK-ut janë paraqitur në mënyrë tabelore.

Lot 1

<i>Komuna</i>	<i>Zona Kadastrale</i>	<i>Anëtar nga ZK</i>
Drenas	Abri e Epërme	Liridon Xhemajli
	Gllanasellë	Muhamet Berisha
	Negroc	Blerim Krasniqi
	Likoshan	Mehmet Gjeli
	Fushitce e Epërme	Arianit Bytyqi
Skenderaj	Prekaz i Epërm	Nezir Rama
	Prekaz i Poshtëm	Avdullah Kodra
	Skenderaj	Gazmend Hoxha
	Klinë e Mesme	Sami Ajeti
	Kryshevc	Samir Gashi
	Aqareve	Musli Haxha
	Marinë	Nazif Ngucati
Vushtrri	Nevolan	Agron Lushaku
	Bivolak	Astrit Klinaku
	Lum Madh	Ferki Osmani
	Ceceli	Irfan Hasani
Suharekë	Suharekë	Lulzim Gashi
	Reshtan	Hazir Morina
	Peqan	Islam Caka
	Studenqan	Leotrim Gashi
	Grejkovc	Halit Kica
Istog	Istog	Musa Ahmetaj
	Lubovë	Shefqet Haxhiaj
	Saradran	Zenun Mavraj
	Kovragë	Qazim Blakaj

Lot 2

<i>Komuna</i>	<i>Zona Kadastrale</i>	<i>Anëtar nga ZK</i>
Shtime	Shtime	Fetah Krasniqi
	Vojnoc	Kadri Shabani
	Muzeqinë	Agim Avdiu
	Petroviq	Nebih Bajrami
	Rashincë	Nehat Canolli
	Davidovc	Idriz Azizi
	Gjurkoc	Nazif Sadriu
Hani i Elezit	Seqishte (Burimi)	Akif Shkreta
	Gorancë	Reshat Berisha
	Paldenicë	Fatmir Dernjani
Kaçanik	Kaçanik	Hasan Bruti
	Bob	Abedin Kuka
	Runjevë	Azem Berisha
	Kaçanik i Vjetër	Shyqeri Krasniqi

	Begracë	Bashkim Luzha
Obiliq	Plemetin	Sylejman Fazliu
	Leshkoshiq	Sabit Dubova
	Sibovc	Bahtir Thaqi
	Grabovc i Epërm	Musa Mjekiqi
Malishevë	Bellanicë	Shefqet Zogaj
	Malishevë	Musa Mazreku
	Banjë	Bajram Gashi
	Llaskadrenoc (Drenoc)	Kapllan Krasniqi
	Damanek	Osman Krasniqi
	Kijevë	Murat Toplani

3. FUSHATA E MATJEVE

Njëri nga aktivitetet më të rëndësishëm në procesin e rindërtimit është fushata e matjeve kadastrale.

Kjo fazë është realizuar që nga fillimi i projektit e deri në mbyllje të shikimit publik në të gjitha Zonat Kadastrale. Fushata e matjeve është një proces i cili zhvillohet gjatë gjithë fazave të realizimit të projektit, që do të thotë deri në mbyllje të Shikimit Publik, i cili zgjat 60 ditë.

Për kompletimin e informacioneve kadastrale për ZK operatori ekonomik ka zhvilluar matjen për pikat referente dhe pikat e detajit për kufijtë e parcelave si dhe për bazamentin e ndërtesës. Gjatë matjeve të kufijëve të parcelave është përdorur edhe Sistemi Referent të Pozicionimit të Kosovë - KOPOS.

Matjet e njëjësive kadastrale – parcelave dhe objekteve, Lot 1.

<i>Komuna</i>	<i>Zona Kadastrale</i>	<i>Nr i Parcelave të matura</i>	<i>Nr. i Objekteve të matura</i>
Drenas	Abri e Epërme	889	529
	Gllanasellë	658	493
	Negroc	805	524
	Likoshan	504	199
	Fushtice e Epërme	470	300
Totali		3326	2045
Skenderaj	Prekaz i Epërm	661	775
	Prekaz i Poshtëm	343	417
	Skenderaj	678	1575
	Klinë e Mesme	216	292
	Kryshevc	268	206
	Aqareve	531	338
	Marinë	187	190
Totali		2884	3793
Vushtrri	Nevolan	526	527

	Bivolak	397	128
	Lum Madh	342	336
	Ceceli	223	128
Totali		1488	1119
Suharekë	Suharekë	578	1017
	Reshtan	168	405
	Peqan	307	520
	Studenqan	155	670
	Grejkovc	175	1022
Totali		1383	3634
Istog	Istog	881	2021
	Lubovë	393	376
	Saradran	720	638
	Kovragë	342	330
Totali		2336	3365

Matjet e njëjësive kadastrale – parcelave dhe objekteve, Lot 2

<i>Komuna</i>	<i>Zona Kadastrale</i>	<i>Nr i Parcelave të matura</i>	<i>Nr. i Objekteve të matura</i>
Shtime	Shtime	1284	2946
	Vojnoc	640	537
	Muzeqinë	465	588
	Petroviq	175	476
	Rashincë	651	592
	Davidovc	291	378
	Gjurkoc	230	321
Totali		3736	5838
Hani i Elezit	Seqishte (Burimi)	397	549
	Gorancë	532	285
	Paldenicë	496	544
Totali		1425	1378
Kaçanik	Kaçanik	564	2014
	Bob	378	455
	Runjevë	156	238
	Kaçanik i Vjetër	621	986
	Begracë	834	852
Totali		2553	4545
Obiliq	Plemetin	542	1027
	Leshkoshiq	491	335
	Sibovc	1180	505
	Grabovc i Epërm	489	202
Totali		2702	2069
Malishevë	Bellanicë	923	875
	Malishevë	396	1142
	Banjë	1123	1580
	Llashkadrenoc (Drenoc)	1086	1345

	Damanek	355	335
	Kijevë	469	581
	Totali	4352	5858

4. SHIKIMI PUBLIK

Pas përfundimit të matjeve kadastrale, formimit të njësive kadastrale, krijimi i regjistrave sipas nenit 15 të këtij Udhëzimi Administrativ operatori ekonomik ka bërë kontrollin e kualitetit të dhënave të krijuara në procesin e rindërtimit. Të dhënat e kontrolluara nga operatori i janë dorëzuar AKK-së.

AKK para shikimit publik ka bërë kontrollin e kualitetit bazuar në kornizat për punë dhe doracakun për kontrolle kualiteti të rindërtimit të kadastrit dhe të kadastrit të ndërtesave.

Pas kontrollave të realizuara nga kontrollat e kualitetit në AKK-ë dhe raporteve nga menagjerët e projektit RIK 50 ZK, Lot 1 dhe 2, Komisioni në takimet e rregullta ka marrë vendim sipas Udhëzimit Administrativ nr. 03/2012 për punën e Komisionit për rindërtimin e kadastrit dhe regjistrat të drejtave mbi pronën e paluajtëshme, për hapjen e shikimit publik në zonën kadastrale, që zgjatë 60 ditë. Mirëpo pas paraqitjes së kërkesave nga pronarët, OE dhe anëtarëve të Komisionit nga Zona Kadastrale, është bërë zgjatja e shikimit publik edhe për disa ditë shtesë, me qëllim të përfitimit sa më të madhë të pronarëve nga projekti. Pas marrjes së Vendimit, Operatori Ekonomik ka filluar të bëjë fushatën e veçantë të sensibilizimit.

Së paku tre (3) ditë para fillimit të shikimit publik janë shpërndarë pllakata dhe fletëpalosje në vendet publike në territorin e ZK si dhe janë shpërndarë derë më derë. Në pllakatë dhe fletëpalosje është shënuar data e fillimit dhe e përfundimit të shikimit publik, vendi ku mbahen të dhënat për shikim publik, orari kur banorët kanë mundësi me i shikuar të dhënat nga rindërtimi, dhe ftesa që u bëhet banorëve që secili të shikon të dhënat për pronat e tyre dhe të drejtën për të parashtruar kërkesa për të marrë sqarime dhe ankesa nëse mendojnë se të dhënat nuk janë të plota ose kanë eventalisht gabime. Pllakatet dhe fletëpalosjet janë publikuar dhe të shpërndarë gjatë gjithë kohës së shikimit publik. Në rastet kur ato janë dëmtuar apo harxhuar ato janë rivendosë dhe është bërë shpërndarja e re e tyre.

Data e fillimit të shikimit publik është publikuar edhe në mjetet e informimit publik.

Angazhime të posaçme janë bërë për njerëzit me aftësi të kufizuara si dhe për analfabetët për t'ju mundësuar informim të plotë për të dhënat e pronave të tyre.

Së paku dy (2) anëtarë të komisionit dhe përfaqësuesi i operatorit ekonomik kanë qëndruar në zyrën - lokalin ku është mbajtur shikimi publik.

Në këtë fazë të realizimit të projektit RIK, është bërë prezantimi i të gjitha të dhënave nga rindërtimi i parcelave dhe të drejtave pronësore.

Nga Operatori Ekonomik është bërë njoftimi i të gjithë banorëve sipas UA nr. 04/2012.

Komisioni gjatë kësaj faze të realizimit të projektit ka mbajtur takime informuese shtes në disa ZK ku është konsideruar e nevojshme.

SHIKIMI PUBLIK LOT 1

Komuna	Nr.	Zona Kadastrale	Shikimi Publik		Afati shtesë	
			Fillimi	Përfundim	Fillimi	Mbarimi
DRENAS	1	Abri e Epërme	31.08.2015	29.10.2015	29.10.2015	06.11.2015
	2	Gllanasellë	26.09.2015	24.11.2015		
	3	Negroc				
	4	Likoshan	26.06.2015	24.08.2015	24.08.2015	12.09.2015
	5	Fushtice e Epërme				
SKENDERAJ	1	Prekaz i Epërm	15.08.2015	13.10.2015	13.10.2015	23.10.2015
	2	Prekaz i Poshtëm	03.08.2015	01.10.2015	01.10.2015	23.10.2015
	3	Skenderaj	11.09.2015	09.11.2015	09.11.2015	14.11.2015
	4	Klinë e Mesme	15.08.2015	13.10.2015	13.10.2015	23.10.2015
	5	Kryshevc	03.08.2015	01.10.2015	01.10.2015	09.10.2015
	6	Aqareve	15.08.2015	13.10.2015	13.10.2015	23.10.2015
	7	Marinë	03.08.2015	01.10.2015	01.10.2015	09.10.2015
VUSHTRRI	1	Nevolan	26.09.2015	24.11.2015		
	2	Bivolak	01.08.2015	29.09.2015	29.09.2015	09.10.2015
	3	Lum Madh	01.08.2015	29.09.2015		
	4	Ceceli	24.08.2015	22.10.2015	22.10.2015	31.10.2015
SUHAREK	1	Suharekë	07.09.2015	05.11.2015	05.11.2015	13.11.2015
	2	Reshtan				
	3	Peqan				
	4	Studenqan				
	5	Grejkovc			05.11.2015	13.11.2015
ISTOG	1	Istog	25.08.2015	23.10.2015	23.10.2015	06.11.2015
	2	Lubovë				
	3	Saradran				
	4	Kovragë				

SHIKIMI PUBLIK LOT 2

Komuna	Nr.	Zona Kadastrale	Shikimi Publik		Afati shtesë	
			Fillimi	Përfundim	Fillimi	Mbarimi
SHTIME	1	Shtime	19.09.2015	17.11.2015		
	2	Vojnoc	27.02.2015	28.04.2015		
	3	Muzeqinë				
	4	Petroviq	19.09.2015	17.11.2015		
	5	Rashincë	11.02.2015	11.04.2015	11.04.2015	28.04.2015
	6	Davidovc				
	7	Gjurkoc	27.02.2015	28.04.2015		
HANI I ELEZIT	1	Seqishte (Burim)	01.08.15	29.09.15	29.09.2015	03.10.2015
	2	Gorancë				
	3	Paldenicë				
KAÇANIK	1	Kaçanik	26.09.2015	24.11.2015		
	2	Bob	19.09.2015	17.11.2015		
	3	Runjevë				
	4	Kaçanik i Vjetër				
	5	Begracë				
OBILIQ	1	Plemetin	30.06.2015	28.08.2015	28.08.2015	11.09.2015
	2	Leshkoshiq	27.02.2015	28.04.2015		
	3	Sibovc	30.06.2015	28.08.2015	28.08.2015	11.09.2015
	4	Grabovc i Epërm	27.02.2015	28.04.2015		
MALISHEVË	1	Bellanic	30.06.2015	28.08.2015	28.08.2015	19.09.2015
	2	Malishevë	26.09.2015	24.11.2015		
	3	Banjë	30.06.2015	28.08.2015	28.08.2015	19.09.2015
	4	Llaskadrenoc (Drenoc)				
	5	Damanek				
	6	Kijevë	01.08.2015	29.09.2015		

5. DORËZIMI I TË DHËNAVE PËR KONTROLLË, SHQYRTIMI DHE APROVIMI NGA KOMISIONI PËR RIK

Pas mbylljes së fazës së Shikimit Publik dhe dorëzimit të dhënave nga Operatori Ekonomik, është bërë kontrolli final nga ana e Kontrollit të Kualitetit në Agjencinë Kadastrale të Kosovës i të gjitha dosjeve të realizuara nga projekti RIK 50. Pas raporteve nga kontrollera e kualitetit dhe menagjerit të proektit, Komisioni ka bërë shqyrtimin e 7160 lëndëve, si dhe është bërë përgaditja e Aktvendimeve.

Pas përfundimit të këtyre proceseve është bërë vulosja dhe protokolimi i të gjitha lëndëve dhe në fund është bërë dorëzimi te Operatorët Ekonomik, për të bërë skanimin dhe futjen e tyre në modulën Crtool dhe Harten Kadastrale (CM).

6. FUTJA E TË DHËNAVE NË MODULIN CRTOOL DHE CM

Procesi i futjes së të dhënave në këtë vegël është zhvilluar mirë dhe nuk kemi hasur në problem, vegël e cila na e ka mundësuar që të kemi një proces të futjes së të dhënave në regjistrin qendror të të dhënave.

Nga ana e AKK-së është bërë kontrolli një nga një e lëndëve të futura në sistem, si kontrolli e fundit para se ato të eksportohen në bazën reale të regjistrit të drejtave mbi pronën e paluajtshëm që është sistemi SIKTK.

7. APROVIMI I PROJEKTIT

Pas realizimit të fazave të projektit nga Operatori Ekonomik dhe pas kontrolleve të bëra nga ana e kontrollit të kualitetit nga ekspertët e AKK-ës. Si dhe gjatë fazës së Shikimit Publik nuk ka pasur ankesa nga qytetarët, pas futjes së të dhënave në Modulën CRTool dhe kontrollit të bërë si nga Operatori Ekonomik, kontrolli i kualitetit dhe nga Komisioni për RIK, bëhet aprovimi i Projektit.

Aprovimin e Projektit e bënë Komisioni për rindërtimin e informacioneve kadastrale në bazë të kompetencave të përcaktuara me Neni 7, paragrafi 5 i Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2012 për punën e Komisionit për Rindërtimin e Kadastrit dhe Regjistrin të të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme.

8. DORËZIMI I TË DHËNAVE FINALE NGA PROJEKTI I RIK-Ë 50 ZK

Pas përfundimit të futjes së të dhënave në CRTool, operatori ekonomik ka bërë dorëzimin final të të dhënave gjatë gjithë projektit që janë mbledhur nga terreni, zyrja dhe gjatë shikimit publik.

9. KONKLuzionet

Në bazë të eksperiencës tonë mund të arrihet në konkluzionin kryesor i cili është se rindërtimi i informacioneve kadastrale për territorin e Republikës së Kosovës është shumë i nevojshëm dhe i domosdoshëm për azhurnimin dhe harmonizimin e të dhënave kadastrale me gjendjen faktike të terrenit. Përmes realizimit të këtij projekti është arritur që të krijohet një bazë e mirë dhe e qëndrueshme për zonat kadastrale të përfshira në këtë projekt. Krijimi i një baze të mirë kadastrale do të iu ndihmoj shumë institucioneve përkatëse për ruajtjen dhe menaxhimin e saktë të të dhënave kadastrale. Gjithashtu rindërtimi i informacioneve kadastrale ndikon direkt në realizimin e projekteve të tjera të rëndësishme si:

- Planifikimet dhe shfrytëzimet e tokës,
- Zhvillimin e infrastrukturës,
- Realizimin e projekteve të komasacionit,
- Menaxhim të saktë të pronës publike dhe
- Tatimi mbi pronën e paluajtshme.

Përfituesit kryesor nga realizimi i projektit për rindërtimin e informacioneve kadastrale kanë qene pronarët e tokave në këto zona kadastrale të cilëve iu është mundësuar zyrtarizimi i pronës e cila nuk është e regjistruar në regjistrat kadastral sipas gjendjes faktike që ata e shfrytëzojnë.

Të gjitha këto shërbime për pronarët e këtyre pronave, deri në marrjen e certifikatës janë realizuar pa ndonjë pagesë.

Duhet marr parasysh faktin se krijimi i regjistrit të saktë për pronën e paluajtshme është edhe njëri nga shumë kushtet për zhvillimin e vendit, investimet e ndryshme nga jashtë si dhe integrimin e vendit në familjen e madhe evropiane.

Sfidat me të cilat jami ballafaquar gjatë realizimit të projektit kanë qenë:

1. Një numër i madhë i të drejtave pronësore të regjistruara në regjistrat kadastral janë në pronarë të vdekur, ku trashëgimtarët e tyre për të realizuar të drejtën e tyre përmes projektit duhet të kryejnë fillimisht procesin e Trashëgimisë te Noterët ose në Gjykata. Duke pasur parasyshë se sipas ligjeve dhe akteve tjera në fuqi Komisioni përmes projektit RIK nuk ka të drejtë që të bëjë shqyrtimin e procesit të trashëgimisë.
2. Rastet e shumta të transaksioneve të pa zyrtarizuara, ku palëve ju mungonin dokumentat juridik për të realizuar të drejtën e bartjes së pronësisë përmes projekti. Palët pjesëmarrëse në këto transaksione janë të vdekur dhe po e vështirsojnë procesin e përfitimeve nga projekti RIK.

Sipas Ligji Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore, Neni 36 - *Për bartjen e pronësisë në paluajtshmëri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme ndërmjet tjetërsuesit dhe fituesit, si bazë juridike për regjistrimin e ndryshimit të pronësisë në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri. Kontrata për bartjen e paluajtshmërisë duhet të lidhet me shkrim në prezencë të dy palëve në një zyrë kompetente.*

Projekti RIK, përmes procesverbaleve të nënshkuara nga palët të shqyrtuara dhe aprovuara nga Komisioni ka mundësuar bartjen e të drejtës së pronësisë në mes palëve në rastet kur te dyja palët janë të pranishëm para Komisionit dhe shprehin vullnetin për bartjen e të drejtës së pronësisë.

3. Shitblerjet e viteve të mëheshme në mes të shqiptarëve dhe serbëve pa përpilim të kontratave, siq thuhet në popull "*vetëm me shtrëngim dore dhe kryerje të pagesës së shumës sipas marrëveshjes gojore të arritur në mes të dy palëve*" dhe mos nënshkrimi i ndonjë kontrate për të mundësuar regjistrimin e asaj të drejte në regjistra kadastral, ka penguar shumë palë në përfitimin nga projekti. Rastet e tilla mund të zgjidhen vetëm me padi për vërtetim pronësie, sepse hynë në kategorinë e kontesteve, ku është kompetenc e Gjykatave.

Të dhëna statistikore nga projekti RIK 50 ZK

Procesverbalet	Deklarata për bashkim	Deklarata për ndarje	Nurmi i vizitorëve	Kërkesa për Zyrtarizim	Parcela të finalizuara	Objekte të matura	Pika detaje të parcelave	Pika detaje të objekteve
7160	1556	2532	5653	502	18258	33644	164105	38696

Nr.rendor	Zyra Kadastrale Komunale	Nr. i procesverbaleve	Nr. i deklaratave për bashkim të parcelave	Nr. i deklaratave për ndarje të Parcelave	Nr. i vizitorëve në zyrat lokale	Nr. i kërkesave për zyrtarizim	Nr. i parcelave të trajtuara me Procesverbaleve	Nr. i objekteve të matura	Totali i parcelave të matura-trajtuara
1	Drenas	577	90	165	405	124	1274	2045	1776
2	Skenderaj	651	135	164	569	102	1386	3793	1836
3	Vushtrri	845	131	188	367	15	1123	1119	1162
4	Suharekë	742	82	142	450	37	1123	3634	1266
5	Istog	576	96	116	479	97	980	3365	1481
6	Shtime	836	244	403	937	25	2215	5838	3736
7	Hani I Elezit	478	148	217	258	26	1439	1378	1425
8	Kaçanik	800	210	355	749	56	2546	4545	2553
9	Obiliq	399	100	164	676	4	1504	2069	2702
10	Malishevë	1256	320	618	763	16	2841	5858	4352